



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr. 469/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarës F.(S.) M. M., nga fshati P., K R., për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP.nr.1659/16, të datës 27.12.2016, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **12.10.2018**, në prani të Prokurores të shtetit Mone Sylja, si dhe të akuzuarës F.M.M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara **F.M.M.** nga fshati P., K R., data e lindjes ..., në fshatin R., K R., e bija e S.dhe e ëma B. e gjinisë S., ka të kryer shkollën fillore, amvise, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e martuar, nënë e 2 fëmijëve, me ID

Ë s h t ë f a j t o r e :

Sepse:

-më dt.04.09.2016, rreth orës 01.00 min. në Spitalin Rajonal "I.G.", në Gj., saktësisht në repartin e Pediatriisë, e akuzuara me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete apo për personin tjetër, në dhomën e repartit të lartcekur, merr telefonin e tipit "I...", ngjyrë hiri pronë e të dëmtuarës K.I., të cilin e njëjta derisa kishte qenë duke u kujdesur për djalëin e saj të sëmurë e kishte lënë duke u mbushur bateri në rrymë, ku pas ndërmarrjes së masave të fshehta për gjetjen e abonentit drejtuar operatorëve të telefonisë mobile në Kosovë, rezultoi se personi N.M., e kishte telefonin e të dëmtuarës në shfrytëzim dhe posedim e të cilin ia kishte dhënë bashkëshortja e tij përkatësisht e akuzuara F.M.- M., me ç' rast të dëmtuarës K. I. i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 779 franga.

- me çka ka kryer veprë penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-s.

Gjykata në mbështetje të nenit 4,17,41,46,49,50,51,73 dhe nenit 325 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarës i shqiptoi:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **3(tre) muajve** i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë ne shumë prej **100.00 (njëqind) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merre formë të prerë e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **5 (pesë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€.(njëzet) euro**, të gjobës.

E dëmtuara , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që ti paguajnë shpenzimet procedurale te përcaktuara nga ana e gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga **20,00.-€**, në afat prej **15 ditësh**, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1659/16, të datës 27.12.2016, e ka akuzuar të akuzuarën F.M.M. , nga fshati P., nga K R. , për shkak të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e çështjes ne Gjykatën Themelore ne Gjakovë lenden P.nr. 469/18, e ka pranuar me dt. 06.09.2018.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.12.10.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurorja Mone Syla, lexoi aktakuzën PP.nr.1659/16 të datës 27.12.2016, me ç ‘rast prokurorja deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës por bënë përmirësimin e të dhënave personale për të akuzuarën si në procesverbalin e shqyrtimit fillestar.

E akuzuara F. M.M. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtoj se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës është penduar për veprën e kryer e të cilën e ka kryer për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e varfër ekonomike, kthimi i telefonit të dëmtuarës si dhe faktin se më parë nuk kam qenë i dënuar nga ana e Gjykatës, të më shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i shtetit Mone Syla, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që e njëjta është e vetëdijshme për pasojat dhe favoret juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat që ndodhen në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se e akuzuara F.M. M. : më dt.04.09.2016, rreth orës 01.00 min. në Spitalin Rajonal “I.G.”, në Gj. , saktësisht në repartin e Pediatriisë, e akuzuara me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete apo për personin tjetër, në dhomën e repartit të lartcekur, merr telefonin e tipit “I.”, ngjyrë hiri pronë e të dëmtuarës K. I., të cilin e njëjta derisa

kishte qenë duke u kujdesur për djalë e saj të sëmurë e kishte lënë duke u mbushur bateri në rrymë, ku pas ndërmarjes së masave të fshehta për gjetjen e abonentit drejtuar operatorëve të telefonisë mobile në Kosovë, rezultoi se personi N.M., e kishte telefonin e të dëmtuarës në shfrytëzim dhe posdim e të cilin ia kishte dhënë bashkëshortja e tij përkatësisht e akuzuara F. M.-M., me ç' rast të dëmtuarës K. I. i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 779 franga.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga e akuzuara i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bere vullnetarisht nga e akuzuara pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të saj.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marr parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga e akuzuara, personalitetin e të akuzuarës si nënë e 2 fëmijëve, sjelljen korrekte e të akuzuarës në gjykim, kthimi i telefonit të dëmtuarës premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jetë më e kujdesshme. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i saj që të gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm ,korrekte dhe e vetëdijshme për pasojat e shkaktuara, të cilat rrethana ndikuan që gjykata të zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara në nenin 74 të KPRK-ës, kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1(një) viti, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale dhe dënimin me gjobë në shume prej 100(njëqind) euro, me bindje se do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të ndikoj tek e akuzuara që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 100 € dhe paushalli gjyqësor në shumë prej 20,00 € është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.469/18 më datë 12.10.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatë së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.